




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT PËR VITIN 2024

Prishtinë, prill 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Institucionit të Avokatit të Popullit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të IAP kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Avokat i Popullit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Avokat i Popullit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Avokat i Popullit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Institucionit të Avokatit të Popullit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Institucionit të Avokatit të Popullit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Institucionit të Avokatit të Popullit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, të paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto kanë për qëllim të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me mangësi në ekzekutimin e pagesave për mallra dhe shërbime si dhe me menaxhimin e pasurisë.

Ky raport ka rezultuar me dy rekomandime, prej tyre një rekomandim është i ri ndërsa një i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë në vitin 2024 ishte 331,072€, prej tyre ishin shpenzuar 248,154€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me blerjen e paisjeve për zyrë, mobiljeve, kompjutera, mirëmbajtjen dhe servisimin e veturave, blerjen e derivateve të naftës, furnizime tjera për nevoja të IAP-së.

Çështja A1 - Pranimi i mallrave pa komision të pranimit

Gjetja Neni 8 pika 4 e Rregullës Financiare 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare, përcakton se, Zyrtari Kryesor Administrativ me vendim duhet të formojë Komisionin për Pranimin e Pasurisë jo Financiare, i cili ka përgjegjësitë të bëjë verifikimin e sasisë, cilësisë, llojin dhe vlerën e pasurisë jo financiare të pranuar si dhe të dokumentuar me procesverbal e që janë në përputhshmëri me kontratën apo urdhër blerjen. Si dhe pika 5 thotë që Komisioni për Pranimin e Pasurisë jo Financiare duhet të jetë në përbërje jo më pak se tre (3) anëtar nga ekspertë të fushës përkatëse, duke përfshirë edhe zyrtarin me përgjegjësi materiale. Anëtar të këtij komisioni në rast nevoje mund të jenë edhe ekspertë të jashtëm. Më tej, tek specifikat teknike (në kontratën “Renovimi dhe mobilimi i zyrës së pranimit-recepcionit dhe depos për nevoja të IAP-së”), në pozicionin 2.3 kërkohet Furnizim me karrige dhe tavolinë (përmasa sipas projektit), Materiali: dru bungu, i gdhendur, i lyer dhe mediapan. Ku, pjesa e uljes te karriga duhet të jetë material tekstili me sfungjer, tavolina 100x60x45. Karrige 25x25x55, seti nënkupton tavolina dhe tri karrige.

Gjatë testimit të pagesave kemi vërejtur se në një rast në vlerë 4,029.70€, IAP nuk kishte formuar komision të pranimit të mallrave/furnizimeve. Pasesa kishte të bënte me furnizim me mobile. Pasi që Zyrtari Kryesor Administrativ nuk kishte formuar komision të pranimit, mallrat ishin pranuar nga menaxheri i kontratës. Më tutje, gjatë ekzaminimit dhe krahasimit të artikujve të pranuar dhe atyre të kontraktuar kemi gjetur se karrigat nuk ishin sipas kontratës, pjesa e uljes nuk ishte me material tekstil dhe sfungjer siç ishte e specifikuar në kontratë. Këto çështje kanë të bëjnë me kontratën “Renovimi dhe mobilimi i zyrës së pranimit-recepcionit dhe depos për nevoja të IAP-së”.

Kjo ka ndodhur për shkak se Zyrtari Kryesor Administrativ nuk e ka konsideruar të nevojshme formimin e komisionit për pranimin e mallrave/furnizimeve, me arsyetimin se menaxheri i kontratës ka pranuar asistencë nga një zyrtar tjetër i IAP-së.

Ndikimi Mos formimi i komisionit të pranimit të mallrave/furnizimeve ka ndikuar që IAP të pranojë mallrat/furnizimet jo plotësisht në përputhje me ato të kontraktuara.

Rekomandimi A1 Avokati i Popullit, duhet të sigurojë që komisionet përkatëse për pranimin e mallrave/furnizimeve janë caktuar me kohë dhe se të gjitha pagesat bëhen bazuar në raportet e pranimit nga komisionet përkatëse sipas rregullave të përcaktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 287,480€, e pasurive jokapitale është 55,234€, si dhe e stoqeve 13,513€.

Çështja B1 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë

- Gjetja** Sipas nenit 6.1 të rregullores nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare - çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj.
- Më datë 27.09.2021 Sekretari i përgjithshëm kishte marrë vendim mbi bazën e rekomandimit të komisionit për tjetërsimin e pasurisë nën 1000€ për dhurimin e pasurive jo financiare të IAP-së, drejtorisë së Arsimit të Komunës së Prishtinës. Më tutje, dorëzim-pranimi i pasurisë në mes të IAP-së dhe drejtorisë së Arsimit të Komunës së Prishtinës ishte bërë me datën 18.10.2021. Megjithatë, pasuritë e dhuruara ende figurojnë në regjistrat e pasurisë jo-financiare të IAP-së. Kjo çështje ishte ngritë edhe në raportin e vitit të kaluar.
- Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme dhe mungesës së përgjegjësisë në kryerjen e detyrave nga zyrtarët kompetent.
- Ndikimi** Mbajtja në regjistër e pasurive që nuk janë në shfrytëzim nga IAP rritë rrezikun për informata jo të sakta mbi gjendjen e pasurisë.
- Rekomandimi B1** Avokati i Popullit duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurisë jo financiare, për të siguruar që regjistrat e pasurisë përmbajnë vetëm pasuritë të cilat i ka në shfrytëzim dhe pronësi të saj.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	1,300,018	1,252,420	1,169,502	1,089,447	1,099,281
Grante Qeveritare - Buxheti	1,300,018	1,238,846	1,169,502	1,089,447	1,099,281
Donacionet e jashtme	0	13,575	0	0	0

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 47,598€. Ky zvogëlim është rezultat i deklarimeve të kursimeve buxhetore.

Në vitin 2024 IAP ka shpenzuar 93% të buxhetit përfundimtar ose 1,169,502€, njëjtë si në vitin 2023.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	1,300,018	1,252,420	1,169,502	1,089,447	1,099,281
Pagat dhe mëditjet	982,521	921,349	921,349	893,072	916,090
Mallrat dhe shërbimet	310,497	324,072	244,484	192,634	161,568
Komunalitë	7,000	7,000	3,670	3,741	4,173
Investimet Kapitale	0	0	0	0	17,450

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 61,172.49€, me Vendim të Qeverisë nr.03/239 me datën 24.12.2024. Realizimi i buxhetit final ishte 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur si rezultat i donacioneve për 13,575€. Realizimi i buxhetit final ishte 75%; dhe
- Buxheti final i shërbimeve komunale ishte i njëjtë me buxhetin fillestar. Realizimi i buxhetit final ishte 52%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Gjatë vitit 2024, IAP ka pranuar mjete financiare nga “Konfiskim i Sigurimit të Ekzekutimit” në vlerën 3,968€, këto mjete janë transferuar në llogarinë e Thesarit të Kosovës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	0	0	3,968	1,420	
Të hyrat jo tatimore	0	0	3,968	1,420	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2023 ka rezultuar me një rekomandime. IAP kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do ta zbatoj rekomandimin e dhënë.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, rekomandimi nuk ishte zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimit dhe mënyrës se si është trajtuar, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).


Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasuritë	Avokati i Popullit duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurisë jo financiare, për të siguruar që regjistrat e pasurisë përmbajnë vetëm pasuritë të cilat i ka në shfrytëzim dhe pronësi të saj.	Gjatë vitit 2024 IAP nuk i kishte larguar nga regjistrat pasuritë e dhuruara Komunës së Prishtinës. Ref.B1	Nuk ka filluar zbatimin


Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Shqiponja Krasniqi, Udhëheqëse e ekipit




Vjosa Hasanaj, Anëtare e ekipit



Mazlumsha Sejfadini, Anëtare e ekipit




Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Prishtinë, 28 mars 2025

Znj. Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme
Zyra Kombëtare e Auditimit
Republika e Kosovës



E nderuara znj. Spanca,

Më lejoni që nëpërmjet kësaj shkrese t'ju njoftoj se kam pranuar draft Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2024.

Me këtë, konfirmoj se pajtohem me gjetjen dhe rekomandimin e këtij Raporti dhe sipas legjisllacionit në fuqi, brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, Institucioni i Avokatit të Popullit do t'ju dorëzoj një Plan të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfaqësojë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Duke ju shprehur konsideratat e mia më të larta, ju falënderoj për mirëkuptim dhe bashkëpunimin tuaj profesional!

Me nderime,


Naajm Qelaj
Avokat i Popullit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.